



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:210087

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05839536

PAKR.nr.680/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Beqir Kalludra, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.S., nga Kamenica, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Gjilan, dhe mbrojtësve së të akuzuarit H.S., av.Fanol Krasniqi dhe Elmi Qerimi, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.90/2021, të dt.26.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me rastin e ankesave, të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe mbrojtësve së të akuzuarit H.S., av.Fanol Krasniqi dhe av.Elmi Qerimi, e sipas detyrës zyrtare anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.90/2021, të dt.26.07.2023, ashtu që çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është anuluar sipas detyrës zyrtare, ankesat, e Prokurorisë Themelore në Gjilan, si dhe mbrojtësve së të akuzuarit H.S., av.Fanol Krasniqi dhe av.Elmi Qerimi, tani për tani janë jolëndore.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.90/2021, të dt.26.07.2023, është shpallur fajtor i akuzuari H.S., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve, të cilin dënim i akuzuari është obliguar që ta mbajë në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit H.S., në dënimin e shqiptuar me burgim në kuptim të nenit 83 par.1 të KPK, i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.09.08.2018, gjerë me dt.07.10.2018.

Është konfiskuar thika e sekuestruar si mjet me të cilin është kryer vepra penale në kuptim të nenit 270 të KPPK.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, dhe atë shpenzimet për ekspertizën mjeko ligjore në shumën prej 50 Euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 150 Euro, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Po ashtu është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, av.Basri Morina, nga Prishtina për përfaqësimin e të dëmtuarit A.D., gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë lëndë penale, shumën e përgjithshme prej 1.267,50 Euro, në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar A.D., dhe përfaqësuesi i autorizuar av.Basri Morina, për realizmin e kërkesës pasurore juridike, janë udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko civil.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike të dëmtuarit A.D1., av.Basri Morina, e njëjta është hedhur si e pa lejueshme.

Mbetet në fuqi aktvendimi i plotfuqishëm për caktimin e dorëzanisë në shumën prej 7.000 Euro, në kuptim të nenit 180 par.3 të KPPK, derisa i akuzuari pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, me të cilin është dënuar me burgim, nuk fillon mbajtjen e dënimit të shqiptuar përkatësisht nëse eventualisht i akuzuari nuk lirohet nga akuza me aktgjykim të formës së prerë sipas mjeteve juridike përkatëse.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, dhe ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim proporcional me veprën penale të kryer.

Po ashtu ankesë të përbashkët kanë ushtruar mbrojtësit e të akuzuarit H.S., av.Fanol Krasniqi dhe av.Elmi Qerimi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, në dëm të akuzuarit, si dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të bëhet rikualifikimi i veprës penale, nga vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, në veprën penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 186 par.3 nën par.3.1 të KPK, ose që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.618/2023, të dt.08.12.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për

Krime të Rënda, PKR.90/2021, të dt.26.07.2023, të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje më të gjatë.

Sa i përket ankesës së përbashkët të ushtruar nga ana e mbrojtësve së të akuzuarit H.S., av.Fanol Krasniqi dhe av.Elmi Qerimi, e njëjta të hudhet si e pabazuar.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.27.05.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar i dëmtuari A.D., si dhe mbrojtësi i të akuzuarit H.S., av.Fanol Krasniqi.

Nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, i akuzuari H.S., përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av.Basri Morina, të cilët janë njoftuar në mënyrë të rregullt.

Po ashtu është njoftuar edhe av.Elmi Qerimi, por nuk ka prezantuar në seancë të kolegjit.

I dëmtuari Argjend Demolli, ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekja penale dhe paraqet kërkesë pasurore juridike, për realizimin e së cilës do të realizoj në kontestin e rregullt civilo juridik.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.S., av.Fanol Krasniqi, ka deklaruar se ngel pranë ankesës së ushtruar me shkrim, duke shtuar se aktgjykimi i ankimuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore të KPPK, sepse dispozitivi i të njëjtit është i pa kuptueshëm dhe kemi të bëjmë me tejkalim të aktakuzës. Po ashtu nuk janë dhënë arsye të qarta pse është refuzuar kërkesa për deklarimin e dëshmitarëve kyç në këtë çështje penale, andaj si i tillë aktgjykimi është i pa pranueshëm.

Kolegji i kësaj gjykate në kuptim të nenit 394 të KPPK, ka vlerësuar ankesat e ushtruara, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se:

Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të tjera të cilat kushtëzojnë anulimin e tij.

Përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ka konstatuar se i njëjti përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat rezultojnë nga dispozitivi i aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, i cili nuk është i qartë, nuk është i kuptueshëm është në kundërshtim me vetveten si edhe arsyet e dhëna nga arsyetim që ndërlidhet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 lidhur me par.2. pika 2.7 të KPPK, dhe lidhur me nenin 369 par.7 të KPPK.

Nga dispozitivi i aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, është bërë përshtkrimi i veprës penale, sikurse është bërë edhe kualifikimi juridik i vrasjes në tentativë, nga neni 178

lidhur me nenin 28 të KPK, mirëpo gjatë përshkrimit ka ngatërresa, duke mos u precizuar elementet inkriminuese të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit H.S., ashtu që ekziston një përzierje e veprimeve inkriminuese të akuzuarit, si dhe dëmtimeve të pësuar nga ana e të dëmtuarit, andaj në këtë drejtim e bëjnë të pa kuptimtë dispozitivin e aktgjykimit.

Sa i përket veprimeve inkriminuese të cilat janë vërtetuar në këtë çështje penale, të njëjtat janë të mangëta dhe parashtrohet pyetja se i akuzuari H.S., e ka kryer këtë vepër penale në dëm të dëmtuarve pasi që dispozitat ligjore fare mirë kërkojnë që të vërtetohet ekzistimi i veprës penale, sikurse është paraparë në nenin 7 të KPK, ku ndër të tjera theksohet: “vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është përcaktuar me ligj, si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal, ose masa e trajtimit të detyrueshëm”, andaj nga ky përkufizim ligjor i veprës penale lindin shumë mëdyshje lidhur me ekzistimin e së njëjtës, duke mos dhënë tiparet e veprës penale të vrasjes në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, që nënkupton se e njëjta karakterizohet me institutin e tentativës.

Në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë duhet të bëjë përshkrimin faktik të veprës penale, të identifikoj veprimet inkriminuese të akuzuarit, duke i vërtetuar të gjitha elementet që e karakterizojnë këtë vepër penale, pasi që të vlerëson të gjitha deklaratat e të gjithë dëshmitarëve, të akuzuarit, si dhe provat materiale, kurse në rastin konkret është bërë njëfarë përshkrimi i të gjitha veprimeve të ndërmarra gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, duke u paraqitur pyetjet dhe përgjigjet të cilat janë përshkruar në të njëjtin, e kjo më së miri shihet në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nga faqja 10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22...etj, që aktgjykim e bëjnë edhe më të pa qartë, sepse fare mirë dihet që seanca gjyqësore mbahet me të vetmin qëllim që të vlerësohen dhe të procedohen të gjitha provat nga shkresat e lëndës, dhe të jepet vlerësimi përkitazi me ekzistimin apo mos ekzistimin e veprës penale, kurse nga ky aktgjykim kemi vërejtur se intenca ka qenë që të shkruhet sa më shumë në të, e jo të vlerësohen të gjitha deklaratat, si dhe të gjitha provat materiale të veprës penale.

Shikuar si tersi aktgjykimin e ankimuar, kolegji i kësaj gjykate vie në përfundim se i njëjti pasi që përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata e shkallës së parë, duhet të ketë kujdes që në përshkrimin faktik të veprës penale të pasqyroj në mënyrë të qartë ekzistimin e veprës penale që përkon me kualifikimin juridik, kurse në rastin konkret kemi edhe institutin e tentativës, pasi që kemi të bëjmë me vepër penale të vrasjes në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, që është obligim i së njëjtës gjykatë që të zbatoj dispozitën e nenit 7 të KPK, sikurse edhe dispozitën e nenit 28 të KPK, e pastaj në kuptim të nenit 7 të KPK, të zbatoj detyrimet e përgjithshme për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, sepse obligimi ligjor qon në drejtim të asaj që të gjitha organet të cilat merren me çështjen penale, sikurse janë policia, prokuroria, si dhe gjykata të shkrijnë tërë profesionalizmin që e kanë për të ardhur në përfundim sa më të drejtë të zgjedhjes së çështjes penale.

Pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përfshihet me këto mangësi, pas marrjes së këtij vendimi, gjykata e shkallës së parë, duhet të përkujdeset që ta ri caktoj çështjen penale,

të veproj sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, sepse edhe ashtu është obligim ligjor, që të caktoj seancën gjyqësore, ti njoftoj të gjitha palët në shkresat e lëndës, të parqet dispozitivin e aktgjykimit, i cili duhet të jetë në harmoni dhe arsyet e dhëna lidhur me çështjen penale, që gjatë punës të gjitha veprimet të cilat i ndërmerr, ti vlerësoj një nga një sikurse provat personale, po ashtu edhe provat materiale, që të vlerësoj ekspertizën mjeko ligjore, përkritazi me lëndimet e pësuar nga ana e të dëmtuarit, duke e thirru në seancë të kolegjit ekspertin mjeko ligjor, sipas rëndësisë së çështjes, të jep relacionet e afërta të të gjitha provave nga shkresat e lëndës, të bëjë vlerësimin e së cilës deklaratë e më pastaj të përkujdeset që aktgjykimi mos të përfshihet me mangësitë sikurse ky i cili ka qenë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, dhe është vendosur që i njëjti të anulohet e sipas rrjedhës së procedurës, të nxjerrë edhe prova të tjera të cilat janë të rëndësishme për vendosjen e çështjes penale, e më pastaj të nxirret vendimi i ri.

Në këtë drejtim kolegji i kësaj gjykate, pasi që ka vendosur të anuloj çështjen penale, përkritazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, e duke vlerësuar se kanë ushtruar ankesë, Prokuroria Themelore në Gjilan, dhe mbrojtësit e të akuzuarit, H.S., av.Fanol Krasniqi dhe av.Elmi Qerimi, tani për tani janë jo lëndore.

Nga arsyet e cekura më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 402 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.680/2023, të datës 27.05.2024

Bashkëpunëtor profesional,
Endrit Ajeti

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetare e kolegjit,
Kadrije Goga Lubishtani

Beqir Kalludra